

DEKRET
Nr.7366, datë 24.3.1990

**PËR NJË NDRYSHIM NË DEKRETIN NR.4650, DATË 9.3.1970 “PËR KUFIRIN
SHTETËROR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në dekretin nr.4650, datë 9.3.1970 “Për kufirin shtetëror të RPSSH”, në nenin 4, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Ujërat territoriale të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë shtrihen gjatë gjithë bregdetit të saj në një gjerësi prej 12 miljesh detare (22 224 m), duke filluar nga vija e drejtë bazë që shkon nga kepi i Rodonit (Muzhlit), kepi i Pallës, i Lagjit (Kalasë së Turrës), i Semanit, derdhja e Vjosës, bregu veriperëndimor i ishullit të Sazanit, kepi i Gjuhëzës e i gjiut të Grames dhe pastaj midis bregdetit shqiptar e ishujve grekë deri përmes Kanalit të Korfuzit. Gjerësia e ujërave territoriale nga derdhja e Bunës në det deri te kepi i Rodonit shtrihet gjer në vijën e kufirit shtetëror shqiptaro-jugosllav”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
Sihat Tozaj

KRYETARI
Ramiz Alia